



PARASHKRIMI I KORRUPSIONIT

2023
2022

2021

2020

2019

2018

2017

2016

2015

2014

2013

Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Me kontribut të: Nuraje Bllaca

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Dhjetor, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Instituti i parashkrimit	5
3. Dukuria e parashkrimit në Kosovë	6
4. Arsyet e parashkrimit.....	6
5. Parashkrimi në vitin 2022.....	8
6. Parashkrimi i korrupsionit mbetet problem	8
7. Rastet e korrupsionit të parashkruara në vitin 2022	10
8. Rastet e korrupsionit të profilit të lartë që rrezikojnë të parashkruhen	11
9. Rastet e tjera të korrupsionit që rrezikojnë të parashkruhen	12

1. Përmbledhje ekzekutive

Një ndër shqetësimet kryesore që e ka shoqëruar sistemin kosovar të drejtësisë tash e disa vite është parashkrimi i lëndëve. Numri i madh i rasteve të parashkruara ndër vite ka qenë çështje problematike në të gjitha fushat e drejtësisë penale në Kosovë.

Përkundër faktit se rastet e korrupsionit, veçanërisht ato që janë të shënjestruara për liberalizim të vizave, duhet të trajtohen me prioritet absolut, kjo nuk ka ndodhur në praktikë. Për këtë arsye, në raste të caktuara, edhe vet këto lëndë janë parashkruar. Arsyet e mos procedimit të lëndëve gjyqësore brenda afateve të përcaktuara me ligj, në parim, janë objektive dhe subjektive. Sa i përket arsyeve objektive, numri i madh i lëndëve, mungesa e gjyqtarëve, mungesa e stafit administrativ e të tjera janë disa nga arsyet të cilat ndikojnë në zvarritjen e trajtimit të rasteve të korrupsionit, e cila zvarritje shkon deri në parashkrim të këtyre rasteve. Por, nisur nga fakti se rastet e korrupsionit konsiderohen si raste të cilat duhet të trajtohen me prioritet, kjo nuk do të duhej të konsiderohej arsye për zvarritjen e këtyre lëndëve.

Gjetjet e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) flasin për mos efikasitet të theksuar në trajtimin e rasteve të korrupsionit, si rrjedhojë e të cilit fakt një numër i konsiderueshëm i rasteve të korrupsionit, gjatë vitit 2022, kanë arritur afatin e parashkrimit. Vetëm gjatë vitit 2022 janë parashkruar rastet ndaj 28 të pandehurve të akuzuar për korrupsion. Këta 28 persona bëjnë pjesë në gjithsej 16 raste. Dëmi, sipas Prokurorisë, në këto raste fillon nga 5 euro deri në 5.4 milion euro. Nëse kalkulohet dëmi i pretenduar nga Prokuroria në këto raste, i bie se vetëm brenda vitit 2022 janë parashkruar rastet e korrupsionit, dëmi në të cilat kalon vlerën prej 6 milion eurove. Madje, kjo vlerë llogaritet të jetë vetëm për 11 raste të korrupsionit, pasi në pesë raste të tjera, Prokuroria nuk e ka përcaktuar dëmin në aktakuzë.

Problemi i parashkrimit të korrupsionit duket se do të jetë evident edhe në vitet pasuese. 10 të akuzuar në rastet e profilit të lartë të korrupsionit rrezikojnë të mbesin pa një vendim meritator, për faktin se rastet e tyre parashkruhen në tri vitet e ardhshme, 7 prej tyre gjatë vitit 2023. Dëmi i pretenduar nga Prokurori i Shtetit në këto raste është mbi 59 milion euro. Janë mbi 101 të akuzuar të tjerë për vepra penale të korrupsionit zyrtar, rastet e të cilëve parashkruhen brenda tri viteve të ardhshme. Nisur nga praktika se si është vepruar deri më tani, rreziku i parashkrimit të të gjitha këtyre rasteve është ekzistencial.

Për këto arsye, gjyqtarët duhet që realisht korrupsionin ta trajtojnë si prioritet, në atë mënyrë që këto lëndë të trajtohen me efikasitet dhe të mos lejojnë që në asnjë rast të korrupsionit të arrihet afati i parashkrimit. Në këtë fushë, mbikëqyrja e KGJK është e domosdoshme.

2. Instituti i parashkrimit

Parashkrimi konsiston në arritjen e afatit të caktuar ligjor, pas të cilit afat, institucionet e humbin të drejtën për ndjekje penale apo shqiptim të dënimit. Në rastet kur arrin afati i parashkrimit, ndjekja penale nuk mund të fillohet, derisa në rastet kur hetimet janë duke u zhvilluar, procedura penale duhet të ndërprehet. Për parashkrimin e ndjekjes penale, institucionet e sistemit të drejtësisë kujdesen sipas detyrës zyrtare. Kështu, pa marrë parasysh ekzistimin e kërkesës së të pandehurit, në secilin rast kur ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale, institucionet nuk duhet ta fillojnë ndjekjen penale, respektivisht duhet ta pushojnë ndjekjen penale¹.

Kodi Penal i ka përcaktuar afatet e parashkrimit, varësisht dënimit të përcaktuar me ligj. Ky kod njihet dy lloj afatesh të parashkrimit: absolut dhe relativ. Me parashkrim relativ nënkuptojmë vonesën e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të ndërmarrë veprimet e caktuara procedurale, për të cilat arsye parashkruhet edhe ndjekja penale. Ndërsa, me parashkrim absolut nënkuptojmë kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale deri në momentin kur vepra penale parashkruhet. Në rastin e dytë, veprimet e institucioneve të drejtësisë nuk janë relevante në raport me afatin e parashkrimit. Afati i parashkrimit absolut është më i gjatë se sa ai relativ. Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka përcaktuar afatet e parashkrimit relativ, derisa afati i parashkrimit absolut është dyfishi i afatit të parashkrimit relativ².

Nisur nga fakti se arritja e afatit të parashkrimit nënkupton pamundësinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të zhvilluar procedurën penale, kjo i bie se në secilin rast kur arrin ky afat, rastet penale mbesin pa u gjykuar në mënyrë meritore. Kështu, parashkrimi amnistion kryerësit e veprave penale. Por, ky afat dëmton edhe personat e akuzuar padrejtësisht, mbi pafajësinë e të cilëve gjykata nuk mund të vendos në merita. Për këto arsye, kërkohet nga institucionet e sistemit të drejtësisë që të veprojnë në mënyrë efikase, në mënyrë që të ulin numrin e rasteve të parashkruara.

Parashkrimi i veprës penale shihet edhe si e drejtë e personit të akuzuar, që i njëjti për shkak të mos efikasitetit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, mos të jenë përjetësisht nën hetim³.b Për këtë arsye, siç është thënë, zgjidhja ligjore e Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës për zgjatjen ekstreme të afateve të parashkrimit nuk është zgjidhje adekuate⁴.

¹ Salihu I. Zhitija H. dhe Hasani F. “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës”. Botimi 1. Prishtinë.. Mars 2014. Faqe 329-330. (Shih linkun: <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

² Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 99-100.

³ Listokin Y. “Efficient Time Bars: A New Rationale for the Existence of Statutes of Limitations in Criminal Law”. Journal of Legal Studies. vol. XXXI. The University of Chicago. 2002. Faqe 99-100.

⁴ Gashi L. dhe Shala G. “Korrupsioni në prag të vjetërsimit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2021. Faqe 5-6. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Korrupsioni-ne-prag-te-vjetersimit-Final.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

3. Dukuria e parashkrimit në Kosovë

Një ndër shqetësimet kryesore që e ka shoqëruar sistemin kosovar të drejtësisë tash e disa vite është parashkrimi i lëndëve. Numri i madh i rasteve të parashkruara ndër vite ka qenë çështje problematike në të gjitha fushat e drejtësisë penale në Kosovë.

Përtej të tjerave, më shqetësuese ka qenë parashkrimi i rasteve të korrupsionit. Mungesa e rezultateve në luftimin e korrupsionit të profilin të lartë ka qenë objekt i vazhdueshëm i kritikave për sistemin e drejtësisë. Parashkrimi i rasteve të korrupsionit në disa raste është konsideruar edhe si amnistim i korrupsionit⁵. Parashkrimi i lëndëve të korrupsionit përballë faktit se këto lëndë duhet të trajtohen me prioritet nga sistemi i drejtësisë është konsideruar si shumë problematik. Njëri nga dokumentet e dala nga Procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit nënvizonte se “[m]onitorimi gjeti se gjatë vitit 2018, lëndët e korrupsionit në gjykatat e Kosovës janë parashkruar, madje edhe ato të shënuara për liberalizim të vizave”⁶. Gjatë viteve 2015-2019, në Gjykatat Themelore janë parashkruar aktakuzat ndaj 50 personave apo 4.56% e lëndëve të zgjidhura⁷. Fatkeqësisht, siç do të shihet në vijim të këtij raporti, dukuria e parashkrimit të rasteve të korrupsionit ka qenë evidente edhe në vitin 2022 dhe rreziku është që të vazhdojë edhe në vitin 2023.

Përtej rasteve të korrupsionit, problematika e parashkrimit ka qenë e shtrirë edhe në raste të tjera penale⁸.

4. Arsyet e parashkrimit

Arsyeja kryesore e parashkrimit të rasteve të korrupsionit është mos procedimi i lëndëve gjyqësore brenda afateve të përcaktuara me ligj. Me qëllim të garantimit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm kohor, i cili gjykim në parim pamundëson parashkrimin e lëndëve, Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar afatet kohore të hetimit dhe gjykimit⁹. Por, për arsye objektive dhe subjektive, këto afate nuk janë zbatuar në masë të madhe, për të cilën arsye ka ardhur edhe deri tek parashkrimi i rasteve të korrupsionit.

⁵ “Iustitia 2 – Amnistia e korrupsionit përmes vjetërsimit të lëndëve”. Iustitia. 08 maj 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/iustitia-amnistia-e-korrupsionit-permes-vjetersimit-te-lendeve-2/>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

⁶ Rishikimi funksional i sundimit të ligjit në Kosovë. “Ngritja e profesionalizmit dhe kompetencës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial”. Ministria e Drejtësisë. Faqe 24.

⁷ Gashi L. dhe Shala G. “Korrupsioni në prag të vjetërsimit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2021. Faqe 5-6. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Korrupsioni-ne-prag-te-vjetersimit-Final.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

⁸ Hashani G. dhe Thaqi M. “Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji VS praktika”. IKD. Prishtinë. Nëntor 2019. Faqe 17. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Krimet-e-Përgjithshme-ne-Kosove-ligji-vs-praktika-10.11.2019-ME-BALLINE.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).; Pergega S. Osmani F. dhe Berisha A. “Krimet kundër integritetit seksual në Kosovë”. IKD. Prishtinë. Maj 2021. Faqe 18. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/05/Raporti-i-Integriteti-seksual-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).; Kadriu M. dhe Pergega S. “Krimet e Rënda në Kosovë - 2019”. IKD. Prishtinë. Tetor 2020. Faqe 26-27. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/IKD-Krimet-e-Renda-2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

⁹ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, neni 159, neni 242, neni 245 dhe neni 285.

Përkundër faktit se rastet e korrupsionit, veçanërisht ato që janë të shënjestruara për liberalizim të vizave, duhet të trajtohen me prioritet absolut, kjo nuk ka ndodhur në praktikë. Për këtë arsye, në raste të caktuara, edhe vet këto lëndë janë parashkruar. Rast ilustrativ për këtë është rasti “FAN”. Ky rast kishte filluar sipas kallëzimit penal të parashtruar nga Policia e Kosovës më 28 prill 2014, derisa aktakuza ishte ngritur më 23 dhjetor 2015. Përkundër faktit se sipas Kodit të Procedurës Penale shqyrtimi fillestar duhet të caktohet brenda afatit prej 30 ditëve, shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar pas më shumë se një viti, por e njëjta ishte shtyrë dy herë me radhë, dhe kishte arritur të mbahet vetëm më 12 korrik 2017, pra pas mbi një vit e gjysmë. Pas 27 seancave gjyqësore, shtatë nga të cilat kishin dështuar të mbaheshin dhe rreth 3 vjet pas ngritjes së aktakuzës, më 8 shkurt 2019 ishte bërë shpallja e aktgjykimit. Mbi një vit më vonë, ky rast ishte kthyer në rigjykim. Pas kthimit në rigjykim, ishin caktuar gjithsej shtatë seanca gjyqësore. Të gjitha këto seanca kishin dështuar dhe asnjë s’kishte pasur mundësi të mbahet. Për këto arsye, ky rast tanimë përfundimisht ka arritur afatin e parashkrimit¹⁰.

Gjatë vitit 2022, IKD ka monitoruar gjithsej 888 seanca gjyqësore në rastet e korrupsionit. 651 prej këtyre seancave janë mbajtur derisa 237 seancave gjyqësore janë shtyer. Kështu, krahas të tjerave, administrimi jo i mirë i rasteve gjyqësore krijon zvarritje dhe kjo është një prej faktorëve i cili ndikon edhe në arritjen e parashkrimit të rasteve të korrupsionit. Me këtë rast, gjyqtarët duhet të gjejnë mënyrë adekuate për administrimin e rasteve gjyqësore, në mënyrë që seancat mos të dështojnë. Njëra prej rekomandimeve në këtë rast do të ishte mbajtja e bllok seancave, në atë mënyrë që për një rast të caktuar, të mbaheshin seancat çdo ditë për një periudhë të caktuar kohore (për shembull 1 javë). Nëse gjyqtarët paraprakisht do të ndërmerren të gjitha veprimet për ta bërë këtë, atëherë një numër i konsiderueshëm i rasteve do të gjykoreshin brenda një periudhe të shkurtë kohore. Po ashtu, edhe cilësia e gjykimit do të ishte më e lartë. Është e ditur se si gjyqtari ashtu edhe palët, e kanë më të vështirë që të dinë detajet për rastet kur nga njëra seancë deri në seancën tjetër kalon një periudhë e gjatë kohore, derisa kjo nuk duket të jetë kaq e vështirë nëse organizohen bllok seanca për këto raste.

Edhe kthimi i shpeshtë i rasteve në rigjykim është një prej arsyeve që krijon vonesa të konsiderueshme në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe si rrjedhojë edhe ky faktor ndikon konsiderueshëm në arritjen e afatit të parashkrimit¹¹. Ndryshimi i trupeve gjyqësore është një prej arsyeve të tjera që zvarritjen e lëndëve gjyqësore. Në këto raste, sipas Kodit të Procedurës Penale, gjykimi duhet të filloj nga pika zero. Arsyeja pse vie deri tek ndërrimi i anëtarëve të trupeve gjyqësore ndërlidhet me administrimin jo adekuat të drejtësisë.

¹⁰ “Për shkak të parashkrimit, refuzohet aktakuza për korrupsion ndaj Naser Osmanit dhe të tjerëve lidhur me privatizimin e ndërmarrjes “FAN”. Betimi për Drejtësi. 23 shkurt 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-shkak-te-parashkrimit-refuzohet-aktakuza-per-korrupsion-ndaj-naser-osmanit-dhe-te-tjereve-lidhur-me-privatizimin-e-ndermarrjes-fan/>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

¹¹ Shih p.sh.: “Vendos Apeli, Shukri Bujës i vjetërsohet lënda ku akuzohej për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 7 maj 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/vendos-apeli-shukri-bujes-i-vjetersohet-lenda-ku-akuzohej-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).; “Apeli refuzon akuzën për korrupsion ndaj Ilir Tolajt, shkak arritja e parashkrimit më 12 janar të këtij viti”. Betimi për Drejtësi. 2 shkurt 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-refuzon-akuzen-per-korrupsion-ndaj-ilir-tolajt-shkak-arritja-e-parashkrimit/>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

Në anën tjetër, numri i madh i lëndëve, mungesa e gjyqtarëve, mungesa e stafit administrativ e të tjera janë disa nga arsyet të cilat ndikojnë në zvarritjen e trajtimit të rasteve të korrupsionit, e cila zvarritje shkon deri në parashkrim të këtyre rasteve. Por, nisur nga fakti se rastet e korrupsionit konsiderohen si raste të cilat duhet të trajtohen me prioritet, kjo nuk do të duhej të konsiderohej arsye për zvarritjen e këtyre lëndëve. Për më tepër, gjatë vitit 2022 gjyqësorit i është shtuar edhe një strategji për prioritizim të lëndëve, e sipas kësaj strategjie lëndët të cilat rrezikojnë parashkrimin duhet të trajtohen nga gjyqtarët brenda një afati sa më të shkurtër kohor.¹²

5. Parashkrimi në vitin 2022

Vetëm gjatë vitit 2022 janë parashkruar rastet ndaj 28 të pandehurve të akuzuar për korrupsion. Këta 28 persona bëjnë pjesë në gjithsej 16 raste. Dëmi, sipas Prokurorisë, në këto raste fillon nga 5 euro deri në 5.4 milion euro. Nëse kalkullohet dëmi i pretenduar nga Prokuroria në këto raste, i bie se vetëm brenda vitit 2022 janë parashkruar rastet e korrupsionit, dëmi në të cilat kalon vlerën prej 6 milion eurove. Madje, kjo vlerë llogaritet të jetë vetëm për 11 raste të korrupsionit, pasi në pesë raste të tjera, Prokuroria nuk e ka përcaktuar dëmin në aktakuzë.

Përfundimisht tri rasteve, të gjitha aktakuzat e parashkruara gjatë vitit 2022 janë raste kur koha e kryerjes së veprës penale është viti 2012. Ndaj dy prej personave të akuzuar për korrupsion, rastet e të cilëve janë parashkruar, aktakuza ishte ngritur në vitin 2012, ndaj dy personave në vitin 2013, ndaj një personi në vitin 2014 derisa në shumicën e rasteve (ndaj 9 personave) aktakuza është ngritur në vitin 2015. Kështu, përkundër përcaktimit të qartë të afateve të hetimit në njërin anë dhe zotimit të sistemit gjyqësor për trajtim me prioritet të këtyre lëndëve, ky sistem as për 7 vite nuk ka arritur që në këto raste të nxjerr një vendim meritore të formës së prerë. Për këto arsye, përgjithësisht, arsyet e parashkrimit të këtyre rasteve duken të jenë subjektive, të paktën profesionale, pasi në parim, arsyet objektive nuk do të duhej të ndikonin deri në këtë nivel, që brenda një viti të parashkruhen një numër i konsiderueshëm i rasteve të korrupsionit, trajtimi i të cilave është përcaktuar si prioritet.

6. Parashkrimi i korrupsionit mbetet problem

Siç dihej, zgjatja e paarsyeshme e afatit të parashkrimit të veprave penale nuk e ka zgjidhur problemin e gjyqësorit me lëndë të parashkruara. Në raportin e kaluar të IKD-së mbi parashkrimin e lëndëve të korrupsionit nënvizohet se *“kjo zgjidhje ligjore nuk mund të aplikohet për rastet që gjyqësori ka pasur në punë me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, por vetëm për rastet e reja. Kjo pasi në rastet që gjyqësori ka pasur në punë para hyrjes*

¹²**Shënim:** KGJK me 31 maj 2022 ka miratuar Planin Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 lidhur me efikasitetin dhe prioritizimin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor, ku sipas këtij plani përkatësisht tek Kapitulli VI, pika 1,1 thuhet se: *“Sa i përket lëndëve të fushës penale - që rrezikojnë parashkrimin, gjyqtarët duhet të kujdesen që të trajtohen brenda afatit sa më të shkurtër, duke u kujdesur që seancat të mbahen brenda një periudhe të caktuar kohore dhe të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes, mos trajtimi i lendeve të cilat rrezikojnë parashkrimin ndikon në dëmtimin e imazhit të sistemit të drejtësisë në njërin anë dhe në anën tjetër ndikon edhe në besimin e qytetarëve dhe palëve në sistemin e drejtësisë”*.

*në fuqi të Kodit të ri Penal (prill 2019) aplikohet Kodi Penal paraprak, si ligj më i favorshëm për të pandehurin*¹³.

Kështu, siç u pa, vetëm në vitin 2022, një numër i konsiderueshëm i rasteve kanë arritur afatin e parashkrimit. Në raportin paraprak të kësaj natyre, IKD kishte tërhequr vërejtjen për rrezikun e parashkrimit të rasteve të korrupsionit, ku kishte listuar rastet e korrupsionit të cilat rrezikojnë të parashkruhen. Përkundër kësaj, mungesa e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në trajtimin e këtyre rasteve ka bërë që një numër i konsideruar i lëndëve të korrupsionit të arrijnë afatin e parashkrimit.

Përtej vitit 2022, problemi i parashkrimit të korrupsionit duket se do të jetë evident edhe në vitet pasuese. 10 të akuzuar në rastet e profilit të lartë të korrupsionit rrezikojnë të mbesin pa një vendim meritator, për faktin se rastet e tyre parashkruhen në tri vitet e ardhshme, 7 prej tyre gjatë vitit 2023. Dëmi i pretenduar nga Prokurori i Shtetit në këto raste është mbi 59 milion euro. Janë mbi 101 të akuzuar të tjerë për vepra penale të korrupsionit zyrtar, rastet e të cilëve parashkruhen brenda tri viteve të ardhshme. Nisur nga praktika se si është vepruar më tani, rreziku i parashkrimit të të gjitha këtyre rasteve është ekzistencial.

Për këto arsye, gjyqtarët duhet që realisht korrupsionin ta trajtojnë si prioritet, në atë mënyrë që këto lëndë të trajtohen me efikasitet dhe të mos lejojnë që në asnjë rast të korrupsionit të arrihet afati i parashkrimit. Në këtë fushë, mbikëqyrja e KGJK është e domosdoshme.

¹³ Gashi L. dhe Shala G. “Korrupsioni në prag të vjetërsimit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2021. Faqe 6. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Korrupsioni-ne-prag-te-vjetersimit-Final.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2022).

RASTET E KORRUPSIONIT TË PARASHKRUARA NË VITIN 2022



Emri i të akuzuarit

Koha e veprës penale

Përpilimi i aktakuzës

Parashkrimi i veprës

Dëmi

Naser Osmani	20.01.2012	23.12.2015	20.01.2022	€5,400,000
Bahri Shabani	20.01.2012	23.12.2015	20.01.2022	
Melita Ymeraga	20.01.2012	23.12.2015	20.01.2022	
Adrian Kelmendi	20.01.2012	23.12.2015	20.01.2022	
Shkëlzen Lluka	20.01.2012	23.12.2015	20.01.2022	
Naim Avdiu	20.01.2012	23.12.2015	20.01.2022	
Ilir Tolaj	12.01.2012	04.07.2012	12.01.2022	Nuk përcaktohet
Avni Biqkaj	2004 - 2012	27.10.2015	2022	€486,191.84
Astrit Metaj	2004 - 2012	27.10.2015	2022	
Kujtim Ajvazi	2004 - 2012	27.10.2015	2022	
Shiqeri Spahiu	10.05.2012	09.08.2016	10.05.2022	Nuk përcaktohet
Ramush Thaçi	10.05.2012	09.08.2016	10.05.2022	
Bajram Shehu	31.08.2012	11.08.2014	31.08.2022	€1,061.50
Abdyl Buja	janar 2012	31.05.2018	janar 2022	€3,300.00
Abdyl Buja	shkurt 2012	31.05.2018	shkurt 2022	€2,000.00
Mentor Ismajli	shkurt 2012	31.05.2018	shkurt 2022	
Izet Dibrani	01.03.2016	06.04.2016	01.03.2022	€650
Milan Denda	2010-2012	24.01.2018	2022	Nuk përcaktohet
Milan Denda	2012	25.04.2017	2022	Nuk përcaktohet
Natasha Maksimoviq	16.08.2012	27.08.2018	16.08.2022	Nuk përcaktohet
Valmir Lleshaj	16.08.2012	27.08.2018	16.08.2022	
Ismet Mehmeti	16.08.2012	27.08.2018	16.08.2022	
Nehat Zeqa	tetor 2012	30.08.2013	tetor 2022	€47,270.00
Fisnik Sejdiu	tetor 2012	30.08.2013	tetor 2022	
Bashkim Krasniqi	viti 2012	31.12.2019	viti 2022	€104,674.61
Flurim Gallapeni	14.01.2012	24.09.2012	14.01.2022	€14,319.16
Hasan Selimi	2016	09.09.2021	2022	€800
Ardian Alushaj	korrik 2016	09.09.2016	korrik 2022	€5

RASTET E KORRUPSIONIT TË PROFILIT TË LARTË QË RREZIKOJNË TË PARASHKRUHEN



Emri i të akuzuarit

Koha e veprës penale

Faza e procedurës

Parashkrimi i veprës

Dëmi

**Besim
Beqaj**

08.05.2013

**Vendim i
shkallës së parë**

08.05.2023

**Mimoza
Kusari
Lila**

08.05.2013

**Vendim i
shkallës së parë**

08.05.2023

**Dardan
Gashi**

08.05.2013

**Vendim i
shkallës së parë**

08.05.2023

**Nenad
Rashiq**

08.05.2013

**Vendim i
shkallës së parë**

08.05.2023

**Fllanza
Hoxha**

08.05.2013

**Vendim i
shkallës së parë**

08.05.2023

€13,682,166.41

**Arben
Gjukaj**

08.05.2013

**Vendim i
shkallës së parë**

08.05.2023

€12,628,166.41

**Rexhë
Gjonbalaj**

18.07.2013

**Vendim i
shkallës së parë**

18.07.2023

€32,856,407.28

**Ejup
Qerimi**

Tetor 2014

**Vendim i
shkallës së parë**

Tetor 2024

**Ferid
Agani**

31.12.2015

**Vendim i
shkallës së parë**

31.12.2025

**Gani
Shabani**

31.12.2015

**Vendim i
shkallës së parë**

31.12.2025

**Fillimisht,
€4,555,553
kurse në fjalën
përfundimtare,
€11,450**

Rastet e korrupsionit që rrezikojnë të parashkruhen



Emri i të akuzuarit

Koha e veprës penale

Faza e procedurës

Parashkrimi i veprës

Dëmi

Enver Bytyqi	03.05.2013	Rigjykim	03.05.2023	€31,500.00
Nexhmedin Musliu	03.05.2013	Rigjykim	03.05.2023	€21,000.00
Bashkim Krasniqi	03.05.2013	Rigjykim	03.05.2023	€10,500.00
Ruzhdi Daka	03.05.2013	Rigjykim	03.05.2023	€10,500.00
Abdyl Buja	Nëntor 2013	Shqyrtim gjyqësor	Nëntor 2023	€5000
Mentor Ismajli	Nëntor 2013	Shqyrtim gjyqësor	Nëntor 2023	€5000
Nezir Klinaku	10.01.2013	Vendim i shkallës së parë	10.01.2023	Nuk përcaktohet
Ilmi Zeqiri	10.01.2013	Vendim i shkallës së parë	10.01.2023	Nuk përcaktohet
Sllavisha Vukojeviq	13.02.2013	Vendim i shkallës së parë	13.02.2023	€150
Ali Bejta	01.03.2013	Shqyrtim gjyqësor	01.03.2023	Nuk përcaktohet
Sabri Miftari	2013	Vendim i shkallës së parë	2023	Nuk përcaktohet
Lulzim Beqiraj	23.11.2013	Shqyrtim gjyqësor	23.11.2023	€2,799.00
Bujar Nerjovaj	2011-2013	Rigjykim	2011-2013	€36,143.00
Bujar Nerjovaj	08.04.2013	Shqyrtim gjyqësor	08.04.2023	€104,674.61
Agron Thaqi	2013	Shqyrtim gjyqësor	2023	
Naim Avdyli	2013	Shqyrtim gjyqësor	2023	
Latif Ibrahimimi	19.05.2014	Shqyrtim gjyqësor	19.05.2024	Nuk përcaktohet
Sadik Paçarizi	10.02.2014	Shqyrtim gjyqësor	10.02.2024	€104,674.61
Nijazi Kryeziu	30.05.2014	Shqyrtim gjyqësor	30.05.2024	
Elez Gashi	12.06.2014	Vendim i shkallës së parë	12.06.2024	Nuk përcaktohet
Hasan Ibraj	12.06.2014	Vendim i shkallës së parë	12.06.2024	Nuk përcaktohet
Zeqir Gashi	21.02.2014	Shqyrtim gjyqësor	21.02.2024	€53,000.00
Qazim Reqica	21.02.2014	Shqyrtim gjyqësor	21.02.2024	
Rexhep Gashi	21.02.2014	Shqyrtim gjyqësor	21.02.2024	
Agron Hajrizi	21.02.2014	Shqyrtim gjyqësor	21.02.2024	
Dukagjin Emarllahu	janar 2014	Shqyrtim gjyqësor	janar 2024	Nuk përcaktohet

Rastet e korrupsionit që rrezikojnë të parashkruhen



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Faza e procedurës



Parashkrimi i veprës



Dëmi

Mobere Hyseni	30.05.2014	Vendim i shkallës së parë	30.05.2024	Nuk përcaktohet
Emrush Thaqi	20.05.2014	Vendim i shkallës së parë	20.05.2024	Nuk përcaktohet
Agron Limani	20.03.2018	Shqyrtim gjyqësor	20.03.2024	€5,000.00
Fehmi Ramaj	30.05.2014	Vendim i shkallës së parë	30.05.2024	Nuk përcaktohet
Zenun Elezaj	20.02.2018	Vendim i shkallës së parë	20.02.2024	Nuk përcaktohet
Salih Kqiku	22.10.2014	Vendim i shkallës së parë	22.10.2024	€358.437,91
Hatixhe Përzhella	27.05.2014	Shqyrtim gjyqësor	27.05.2024	Nuk përcaktohet
Fadil Rexhepi	nëntor 2014	Vendim i shkallës së parë	nëntor 2024	Nuk përcaktohet
Remzi Bislimi	nëntor 2014	Vendim i shkallës së parë	nëntor 2024	Nuk përcaktohet
Zenë Rushiti	Prill 2014	Vendim i shkallës së parë	Prill 2024	Nuk përcaktohet
Nezir Aliu	12.06.2014	Vendim i shkallës së parë	12.06.2024	Nuk përcaktohet
Bekim Gashi	19.09.2014	Vendim i shkallës së parë	19.09.2024	€12.622.86
Marko Mlladenoviq	19.09.2014	Vendim i shkallës së parë	19.09.2024	
Egzon Hyseni	prill 2019	Shqyrtim gjyqësor	prill 2025	€2,500.00
Gani Bajraktari	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Daut Gorani	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Reshat Emra	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Hamza Selmani	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Ismail Avdimetaj	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Aferdita Selmanaj	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Salih Shala	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Nehat Rexhepaj	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Agron Besimi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet

Rastet e korrupsionit që rrezikojnë të parashkruhen



Emri i të akuzuarit

Koha e veprës penale

Faza e procedurës

Parashkrimi i veprës

Dëmi

Bajram Mziu	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Petrit Ademaj	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Agron Leka	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Driton Miftari	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Besim Guda	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Mirdi Strana	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Shemsedin Shabollari	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Fisnik Hima	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Luan Pazhari	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Galina Berisha	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Bajram Preteni	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Lulzim Kamberi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Faik Shatri	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Ejup Pllana	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Florim Sadiku	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Halim Halili	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Agim Krasniqi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Hajdin Çitaku	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Edmond Haliti	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Besnik Koliqi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Afrim Poniku	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Banush Gashi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Nebi Musliu	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Xhevdet Krasniqi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Dardan Koqinaj	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Lazer Prekpalaj	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Rexhep Manaj	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Kelmend Pallaska	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Arlind Batalli	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Masar Gashi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Murat Abazi	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet

Rastet e korrupsionit që rrezikojnë të parashkruhen



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Faza e procedurës



Parashkrimi i veprës



Dëmi

Elfedin Muhaxheri	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Nexhmi Zeqiri	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Ferid Susuri	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Ferihane Sefa	31.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Selatin Retkoceri	12.10.2015	Shqyrtim gjyqësor	12.10.2025	€9.995,77
Remzi Lumnica	12.10.2015	Shqyrtim gjyqësor	12.10.2025	€9.995,77
Fidan Pacolli	06.05.2015	Shqyrtim gjyqësor	06.05.2025	€2,500.00
Sabri Maliqi	06.05.2015	Shqyrtim gjyqësor	06.05.2025	€2,500.00
Almir Saiti	22.10.2015	Shqyrtim gjyqësor	22.10.2025	Nuk përcaktohet
Muhamet Bajrami	22.10.2015	Shqyrtim gjyqësor	22.10.2025	Nuk përcaktohet
Nehat Basha	28.08.2021	Shqyrtim gjyqësor	28.08.2025	Nuk përcaktohet
Nijazi Kryeziu	31.12.2015	Rigjykim	31.12.2025	€7200 euro
Afrim Matoshi	2015	Vendim i shkallës së parë	2025	Nuk përcaktohet
Muhamet Beqiri	2015	Vendim i shkallës së parë	2025	Nuk përcaktohet
Enver Franca	janar 2015	Vendim i shkallës së parë	janar 2025	Nuk përcaktohet
Maxhun Maloku	2015	Vendim i shkallës së parë	2025	Nuk përcaktohet
Salih Kqiku	14.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	14.12.2025	€29.017,54
Valon Shefkriu	14.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	14.12.2025	
Izet Kurteshi	14.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	14.12.2025	
Ganimete Kastrati	14.12.2015	Shqyrtim gjyqësor	14.12.2025	
Dimitrije Racicevic	18.11.2015	Shqyrtim gjyqësor	18.11.2025	Nuk përcaktohet